



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROTOKOLLI 4**

**REND-DITE**

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 27.01.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Janar 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve të pastreha që do të përfitojnë nga subvencionimi i qirasë”.
5. **Projekt-Vendim** “Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit”.
6. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime të vendimit të këshillit bashkiak Kolonjë nr.44 datë 07.07.2016, për tarifat shtesë në sektorin e kullotave”.
7. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime dhe shtesë informacioni në vendimin nr 20, datë 27.01.2026 “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për agro-kultivimi-perpunimi bimësh medicinale dhe frutore”
8. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime dhe shtesë informacioni në vendimin nr 23, datë 27.01.2026 “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për ndertimin e parkut fotovoltai”.
9. Informacion.
10. Raport për vendimmarrjen dhe performancën e këshillit të bashkisë Kolonjë për vitin 2025.

**Protokolli i mbajtur sot më datë 26.02.2026 në mbledhjen e rradhës sipas njoftimit të dhënë në datën 20.02.2026.**

**Të pranishëm:** E. Xhelili, B.Jashari, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Avdi, S.Larti, I.Hodo, E.Çikopana.

**Mungon:** A.Tartari, H.Iljazi, I.Milo, T.Çaçani, A.Zeneli.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e datës 26.02.2026, pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së dates 27.01.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës ekonomike të familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Janar 2026, që nuk kanë marr pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tre të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve të pastreha që do të përfitojnë nga suvencionimi i qirasë”.

I.Hodo: Dokumentat i ka të plotësuar saktë jemi dakord.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën katër të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës “Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit.

Z.Meto: Është procedurë jemi dakort.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën pesë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës “Për disa ndryshime dhe shtesë informacioni në vendimin nr 20, datë 27.01.2026 “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për agro-kultivimi-perpunimi bimësh medicinale dhe frutore”

P.:Çunge: Kemi disukutuar disa herë por në këtë projekt-vendim është cituar ajo pika për shtegëtimin e bagëtive me kamion apo mjete të tjera që sigurojnë transportin e blektorisë, ku ne e kemi kërkuar vetë dhe jemi shumë dakord me këtë pikë.

Z.Meto: Unë kisha një pyetje inxhinier, këto tarifa që janë janë paraqitur kanë ardhur me vendim nga Këshilli I Ministrave, mos do ishte më mirë që me këtë vendim mos merret Këshilli Bashkiak.

E.Çuka : (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Duhet patjetër që të merret një vendim i Këshillit Bashkiak. Më pas do të njoftohet edhe pjesa e fermerëve për ndryshimet e tarifës. Prandaj është e domosdoshme që të merret një vendim i Këshillit Bashkiak.

Z.Meto: Pjesa e tarifës në rregull, por pjesa e shtegëtimin.

E.Çuka: ( Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): E kemi diskutuar për të disatën herë që shtegëtimi do e duam ta bejne me transport automjeti, sepse dëmtojnë banorët e Kolonjës kur transportojnë në rrugë urbane me këmbë. Duhet gjetur një rrugë e përbashkët dhe pjesa më e mire ishte kjo, siç vijnë deri në qytetin e Përmetit me kamion dhe në Kolonjë të shtegëtojnë me kamion.

E.Xhelili: Të zbrasin nga kamioni kur të arrijnë në malin Gramoz.

Z.Meto: Unë si fermer do paguaj këto tarifa që keni caktuar ju, jam në zbatues i ligjit edhe ti që vjen nga jashtë zbatoje ligjin.

E.Çuka ( Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): “Në kullotat tona kemi bagëti që vijnë nga zona e Konispolit dhe Sarandës. Nuk vijnë në toka shtetërore pronë e bashkisë Kolonjë, por të gjitha në toka private. Është vendosur një tarifë për shtegëtimin në vlerën rreth 100 mijë lekë të vjetra, por kjo tarifë nuk është zbatuar asnjëherë, ka pasur problem.

Z.Meto: Dhe private është në zbatim të ligjit nuk do kalojë tokë private dhe në tokë shtetërore.

S.Kodra: Më shumë ne rrugën ku ata kalojnë tokë private është ska tokë shtetërore.

E.Çuka ( Specialis Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Mali i Gramozit është prone Bashkiake por ka dhe pronë private sepse janë marre tokë me vendimin e këshillit të Kthimit të kompesimit të pronave. Shtegëtimi është bërë për shtetë, edhe private që kemi një pjesë pagaujn një pjesë nuk paguan, çdo fermer I huaj që vjen nga Konispoli, Saranda pagua tarifën e tij.

Z.Meto: Ju përse nuk e informoni pronarin privat që dhe ai të paguaj pjesën e tij?

E.Çuka ( Specialis Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): I kemi informuar.

P.Çunge: Nëse ky vendim miratohet nga prefekturat, ai t’i dërgohet Policisë së Shtetit dhe Policisë bashkiake, si dhe Administratorëve të zonave, për zbatim.

E.Çuka ( Specialis Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Pas miratimit nga prefektura, do të dërgojmë shkresë zyrtare edhe në Bashkia Konispol dhe në Bashkia Sarandë, me qëllim informimin e plotë blektorëve përkatëse atje.

I.Hodo: Shtegtarët kanë gjetur prekrahe nga disa banor të zones duke menduar se mund të veprojnë sipas dëshirës. Ne jemi dakord, pasi këtë e kemi kërkuar vetë me vendim.

E.Çuka ( Specialis Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Ekzistojnë edhe disa faktorë të tjerë negativë që ndikojnë në shtegtim, pasi në rrugët nëpër të cilat do të kalojmë mund të përhapen sëmundje që rrezikojnë bagëtitë. Gjithashtu, bagëtitë e zonës sonë mund të rezultojnë veçanërisht të ndjeshme ndaj këtyre sëmundjeve. Qëndrimi i parë i tyre do të jetë në fshatin Starje për periudhë kontrolli, dhe më pas do të vazhdojnë drejt vendndodhjes përkatëse.

Z.Meto: Shërbimi veterinar duhet të jetë aktiv.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën gjashtë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatë të rendit të ditë “Për disa ndryshime dhe shtesë informacioni në vendimin nr 20, datë 27.01.2026 “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për agro-kultivimi-përpunimi bimësh medicinale dhe frutore”

Z.Meto: Ne, si në mbledhjen e kaluar ashtu edhe në këtë mbledhje, jemi dakord me projektvendimin për dhënien me qira të tokës për përfaqësuesit primarë, me qëllim agrokultivimin, punimin dhe mbjelljen e bimëve medicinale dhe frutore. Megjithatë, nuk dëshirojmë që ky projektvendim të kthehet nga prefektura për rishqyrtim. Kërkojmë që ai të sanksionohet në Bashkia Kolonjë, në mënyrë që të mos ketë asnjë pasaktësi apo gabim procedural.”

E.Çuka: ( Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit) Duke marrë në shqyrtim shkresën e ardhur nga Prefektja e Qarkut Korçë, me anë të së cilës na është kthyer për rishqyrtim projektvendimi, bëjmë me dije se këtë herë kemi plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu, kemi zhvilluar diskutime me punonjësit e Prefekturës dhe kemi përmbushur çdo kërkesë procedurale sipas udhëzimeve të dhëna.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën shtatë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditë “Për disa ndryshime dhe shtesë informacioni në vendimin nr 23, datë 27.01.2026 “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e parkut fotovoltaiik.”

I.Hodo: Ku ndodhet kjo parcela?

E.Çuka: (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Zona në fjalë ndodhet në ish-repartin ushtarak të vjetër në Radom. Fillimisht, ne kemi përcaktuar një sipërfaqe të caktuar në hektarë. Megjithatë, pas përfundimit të procedurës së tenderimit, kemi të drejtë që sipërfaqja e parcelës të përcaktohet në përputhje me kërkesën dhe kapacitetin e subjektit përgjegjës, sipas kritereve të vendosura.

Z.Meto: Në këtë sipërfaqe a demtohen banoret e zonës?

E.Çuka ( Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Ne e kemi zhvilluar dëgjesa publike. Në të kanë marrë pjesë edhe këshilltarët. Kemi zhvilluar vizitë në terren së bashku me banorët e zonës përreth dhe kemi diskutuar në vendndodhje. Zona ndodhet shumë larg nga qendra e banimit dhe banorët janë shprehur dakord që projekti të realizohet në atë vend.

E.Xhelili: “Në këtë proces janë përfshirë edhe dy blektor të zonës, të cilët ushtrojnë aktivitete blegtorale, dhe kanë dhënë pëlqimin e tyre që zhvillimi të realizohet në vendndodhjen e propozuar.”

I.Hodo: Jemi dakord është shumë larg zonave të banimit.

Z.Meto: Aty subjekti zhvillon edhe zonën, por mirëmban edhe rrugët.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën nentë Informacion.

M.Gora ( Specialiste emergjenca Civile): Zonja në fjalë nuk përfiton, pasi në momentin kur ka ndodhur fatkeqësia nuk ka qenë banuese në atë banesë, por ka jetuar në Tiranë. Për rrjedhojë, certifikata familjare rezulton e regjistruar në Tiranë. Në këto kushte, ne nuk mund të procedojmë me mbulimin e dëmit të banesës, për sa kohë nuk plotësohet dokumentacioni i kërkuar sipas kritereve në fuqi.

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën dhjetë Raport per vendimarrjen dhe performancën e keshillit të bashkisë Kolonjë per vitin 2025.

Z.Meto: Prezanton Raport per vendimarrjen dhe performancën e keshillit të bashkisë Kolonjë për vitin 2025.

**Proces-Verbali i datë 26.02.2026 është firmosur nga 10 anëtarë Këshilli.**

SEKRETAR I KËSHILLIT

INSUJDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

